

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, koleji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Mustafa, kryetare Avdi Dinaj dhe Nebojsa Boriçiq, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarit H. H., nga Komuna e Vitisë, për shkak të veprës penale sulm ndaj personit zyrtar nga neni 317 par. 1 lidhur me nenin 23 të KPK, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga i dënuari, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Viti, P.nr.207/2015 datë 12.5.2015 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Prishtinë, PA1.nr.860/2015 datë 7.9.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur më 17 maj 2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit H. H., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Viti, P.nr.207/2015 datë 12.5.2015 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Prishtinë, PA1.nr.860/2015 datë 7.9.2015.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Viti, P.nr.207/2015 datë 12.5.2015, i dënuari H. H. është shpallur fajtor për veprën penale sulm ndaj personit zyrtar nga neni 317 par. 1 lidhur me nenin 23 të KPK dhe për këtë vepër penale është gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh, mirëpo, dënimi i shqiptuar me pëlqimin e të dënuarit iu është zëvendësuar në dënim me gjobë në shumë prej 1.200 €, të cilën është detyruar ta paguajë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, e në rast të

mospagese e njëjta do t'i zëvendësohet me dënim burgu ku për çdo 20 € të filluar do t'i llogaritet një ditë burgim. Është detyruar i dënuari që ta paguaj shumën paushalle prej 20 € të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Të dëmtuarit Xh. L., A. M. dhe R. B. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Ky aktgjykim është ndryshuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Prishtinë, PA1.nr.860/2015 datë 7.9.2015, në mënyrën sa vijon:

“Me aprovimin e ankesës së Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Viti, P.nr.207/2015 datë 12.5.2015, vetëm përkitazi me vendimin për dënimin, ashtu që Gjykata e Apelit në Prishtinë të akuzuarin H. H., për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor e gjykon me dënim burgu në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajsh, të cilin dënim do ta mbajë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.”

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur i dënuari H. H., siç rrjedh nga kërkesa për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Prokurori i Shtetit të Kosovës me parashtrësën KMLP.II.nr.18/2016 datë 2.2.2016 ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit i shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes konform dispozitave të nenit 435 par. 1 dhe 436 par. 1 të KPPK-së, dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Në kërkesën e ushtruar i dënuari theksohet se Gjykata e Apelit ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ndërsa për seancën e kolegjit fare nuk është njoftuar duke konsideruar se janë shkelur dispozitat e procedurës penale ndërsa të dënuarit iu është pamundësuar të sqarohet lidhur me pretendimet ankimore të theksuara në ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme pretendimet e mësipërme nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk qëndrojnë për faktin se nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor i datës 12.5.2015 rrjedh se shqyrtimi gjyqësor është mbajtur në prezencën e të dënuarit, se i dënuari është udhëzuar mbi të drejtat e tij në procedurë, ku në mënyrë taksative i dënuari deklarohet se jo vetëm që i ka kuptuar të drejtat e tij në procedurë por e ka kuptuar edhe akuzën, ku më pastaj i dënuari deklarohet se i ka kuptuar udhëzimet e gjykatës si dhe favoreet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, i cili në mënyrë decisive deklaron se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, me premtim se në të ardhmen nuk do ta përsërisë një veprim të tillë dhe pasi që gjykata konstaton se pranimi i fajësisë nga ana e të dënuarit është bërë në mënyrë vullnetare, merr aktvendim mbi pranimin e fajësisë nga ana e të dënuarit.

Vlen të theksohet se konform dispozitës së nenit 432 par. 2 të KPPK-së kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike.

Nga ana tjetër duhet theksuar se konform dispozitës së nenit 390 par. 1 të KPPK-së, njoftimi për seancën e kolegjit pranë Gjykatës së apelit i dërgohet Prokurorit të shtetit kompetent, të akuzuarit, mbrojtësit të tij si dhe të dëmtuarit vetëm në rastet kur të akuzuarit i është shqiptuar dënimi me burgim efektiv, andaj drejt ka vepruar gjykata e shkallës së dytë kur të dënuarin H. H. nuk e ka njoftuar për seancën e kolegjit ngase në rastin konkret seanca e kolegjit mbahet pa praninë e tyre.

Në të kundërtën duhet theksuar se cilësimi juridik i veprës penale është rezultat i provave që gjenden në shkresat e çështjes e që si të drejta dhe të ligjshme si dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të shkallës së dytë të shprehura në aktgjykimet e kundërshtuara i aprovon edhe kjo Gjykatë. Pra, drejt janë aplikuar edhe dispozitat e Ligjit material.

Nga sa u parashtrua më lartë e konform dispozitës së nenit 437 të KPPK-së , u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

PML.nr. 23/2016 datë 17 maj 2016

Procesmbajtëse,
Qefsere Berisha

Kryetare e kolegjit,
Emine Mustafa